

AMF pjesëmarrëse në Javën Globale të Investitorit në kuadër të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO)

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-gusht 2019
- Tregtimi i titujve në Bursën ALSE, 3-mujori i tretë 2019

Zhvillime të tjera

- AMF zhvillon një takim pune pranë Autoritetit të Tregjeve Financiare të Francës
- Zhvillohet forumi i parë mbi mbikëqyrjen e sigurimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor
- Zhvillohet konferenca e pestë vjetore mbi konceptet themelore në sigurime

Edukimi i Konsumatorit

- Klasifikimi i tregjeve financiare sipas pretendimeve

Botime Profesionale

Lajme Ndërkombëtare

- Hungari
- Kosovë
- Kroaci
- Mali i Zi
- Maqedoni e Veriut
- Poloni
- Rumani
- Serbi
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF nis Javën Globale të Investitorit me aktivitetin me përfaqësues të bizneseve dhe shoqatave të tregjeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi më datë 30 shtator 2019, një takim informues me përfaqësues të bizneseve nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës dhe shoqatave të tregjeve nën mbikëqyrje, në nisje të aktiviteteve në kuadër të Javës Globale të Investitorit.



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Koçi dhe Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, z. Nikolin Jaka gjatë aktivitetit

○ ○ ○
Në fjalën e mbajtur, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, theksoi rëndësinë e përfshirjes së bizneseve në tregun e kapitalit, si një mundësi shumë e mirë jo vetëm për të siguruar financime, por edhe për të kontribuar direkt në rritjen ekonomike të vendit.

○ ○ ○
Në fjalën e mbajtur, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, theksoi rëndësinë e përfshirjes së bizneseve në tregun e kapitalit, si një mundësi shumë e mirë jo vetëm për të siguruar financime, por edhe për të kontribuar direkt në rritjen ekonomike të vendit.

“Aktualisht, raporti i huave kredituar ndaj depozitave në sektorin bankar është poshtë nivelit 50%, që nënkupton se thellimi i tregut financiar nëpërmjet zhvillimit të tregut të kapitalit është domosdoshmëri për zhvillimin ekonomik të vendit. Thellimi i sektorit financiar do të kontribuojë jo vetëm në angazhimin e burimeve të pashfrytëzuara drejt sektorëve të ekonomisë reale, por edhe rritjen e alternativave të financimit dhe reduktimin e kostove për biznesin në tërësi,” u shpreh Z. Koçi.

Nga ana e tij, Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Z. Nikolin Jaka, tha se instrumentet e tregut të kapitalit janë sot një domosdoshmëri, në mënyrë që biznesi shqiptar të jetë sa më konkurrues në epokën e globalizmit.

Java Globale e Investitorit (30 shtator – 6 tetor) organizohet në të gjitha vendet që aderojnë pranë Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), me aktivitete me karakter ndërgjegjësues dhe informues në lidhje me tregun e kapitalit, fondet e investimeve dhe pensionet private. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të organizojë aktivitete të tjera dhe orë të hapura me grupe interesi, në bashkëpunim me aktorët e këtij tregu në vend.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-gusht 2019


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-gusht kapën vlerën mbi 11,364 milionë lekë, ose 2.33% më shumë se në periudhën janar-gusht 2018. Gjatë periudhës janar-gusht 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 885,298 me një rritje 4.72% krahasuar me periudhën janar-gusht 2018.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.41% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.25% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.34%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.86% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.14% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-gusht 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,939 milionë lekë, ose 9.99% më shumë se në periudhën janar-gusht 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-gusht kapën vlerën mbi 11,364 milionë lekë, ose 2.33% më shumë se në periudhën janar-gusht 2018.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-gusht 2019



Tregtimi i titujve në Bursën ALSE, 3-mujori i tretë 2019

Sipas të dhënave statistikore të Bursës ALSE, gjatë muajve korrik, gusht, shtator 2019, në këtë bursë janë tregtuar Bono Thesari në vlerën 13,239,315 lekë dhe Obligacione në vlerën prej 388,477,100 lekë. Duke analizuar numrin e transaksioneve dhe volumin e tregtuar, gjatë këtyre muajve, kanë dominuar transaksionet e *on-exchange*.

Nga të dhënat e tregtimit në ALSE, për muajt korrik, gusht, shtator 2019, sipas llojit të transaksioneve, kanë dominuar në volum, vlerë dhe numër transaksionet e ekzekutuara për llogari të klientëve.

Tregtimi i Titujve të Qeverisë të R.Sh. në Bursën ALSE		
Lloji i Transaksionit	Vlera e Tregtimit (Në Lekë)	
	Bono Thesari	Obligacione Thesari
Për Anëtarët	8,192,605	56,297,250
Për Klientët	5,046,710	332,179,850
Individë	5,046,710	27,485,300
Persona Juridike	0	304,694,550
TOTAL	13,239,315	388,477,100

ZHVILLIME TË TJERA

AMF zhvillon një takim pune pranë Autoritetit të Tregjeve Financiare të Francës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me synim përfitimin nga praktikat më të mira mbikëqyrëse e rregullatore, si dhe intensifikimin e marrëdhënieve me organizmat partnere, zhvilloi në datë 6 shtator 2019 një takim pranë Autoritetit të Tregjeve Financiare të Francës. Të dy autoritetet mbikëqyrëse janë anëtare dhe nënshkruese të marrëveshjes së bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, IOSCO.



Momente nga takimi me drejtuesit e Autoritetit të Tregjeve Financiare të Francës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me synim përfitimin nga praktikat më të mira mbikëqyrëse e rregullatore, si dhe intensifikimin e marrëdhënieve me organizmat partnere, zhvilloi në datë 6 shtator 2019 një takim pranë Autoritetit të Tregjeve Financiare të Francës.

Përfaqësues të AMF-së në këtë takim ishin z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, si dhe z. Niko Kotonika, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve. Gjatë takimeve midis dy autoriteteve u diskutua marrja e eksperiencave më të mira dhe shkëmbimi i informacionit në drejtim të zbatueshmërisë, zhvillimeve në tregjet e teknologjisë financiare (FinTech), strukturave organizative, mbështetur në kompetencat që jep legjislacioni përkatës.

Në prezantimin e tyre, përfaqësuesit e Autoritetit të Tregjeve Financiare të Francës paraqitën strukturën e zbatueshmërisë, rëndësinë që ka kjo strukturë, në lidhje me krijimin e një tregu sa më të drejtë dhe transparent, duke i shërbyer mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit. Ekspertët francezë ofruan përvojën e tyre mbi monitorimin e tregut dhe hapat e procesit të inspektimit të shoqërive në treg. Ata trajtuan edhe ndërveprimin me struktura të tjera jashtë Autoritetit, shkëmbimin e informacionit në kuadër të marrëveshjes me IOSCO.

Një pikë tjetër diskutimi lidhej me zhvillimet e fundit të instrumentave financiare (aktivet virtuale) që mbështeten mbi teknologjinë e ditarit të shpërndarë (DLT) si dhe zhvillimet e fundit duke përfshirë kuadrin ligjor dhe rregullator francez në lidhje me këtë fushë.

Z. Koçi falënderoi përfaqësuesit e Autoritetit francez në lidhje me takimin, duke vënë theksin në rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në drejtim të zhvillimit dhe adresimit të çështjeve të ndryshme të tregut të kapitaleve. Ndërkohë ai kërkoi mbështetjen e Autoritetit të Tregjeve Financiare të Francës në drejtim të projekteve të asistencës teknike.

Të dy autoritetet do ta vazhdojnë më tej bashkëpunimin me pjesëmarrjen në konferenca, takime dhe shkëmbimin e informacionit.

Zhvillohet forumi i parë mbi mbikëqyrjen e sigurimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor



Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) organizoi në Frankfurt forumin e parë “Mbikëqyrja e Sigurimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor”.

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) organizoi në Frankfurt forumin e parë “Mbikëqyrja e Sigurimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor”. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi ishte i pranishëm në këtë aktivitet, ku u diskutua në lidhje me situatën e tregut të sigurimeve në rajon, çështjet kryesore të rregullimit dhe mbikëqyrjes, si edhe mundësitë e rritjes së bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Z. Koçi i njohu pjesëmarrësit me disa nga hapat e ndërmarra nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të përafrimit të kuadrit ligjor e rregullator me direktivat evropiane, forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve, si edhe mbrojtjen e rritjen e edukimit financiar të konsumatorëve.

Pjesëmarrësit në këtë forum ndanë qëndrimin se zhvillimi ekonomik i vendeve të Ballkanit Perëndimor është i lidhur ngushtë me procesin e integritit evropian. Aspirata e këtyre vendeve për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian i vë ata përpara detyrimit për të reformuar tregun e sigurimeve dhe kuadrin e tij ligjor. Krahasuar me mesataren e BE-së, tregu i sigurimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet pak i zhvilluar, por me potenciale të mëdha për rritje të mëtejshme.

Agjencia e Mbikëqyrjes
së Tregut të
Sigurimeve të
Sllovenisë (AZN)
zhvilloi në 6 shtator në
Lubljanë, Slloveni
konferencën e 5-të
vjetore mbi konceptet
themelore në sigurime
"Back to Basis".

Zhvillohet konferenca e pestë vjetore mbi konceptet themelore në sigurime

Agjencia e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve të Sllovenisë (AZN) zhvilloi në 6 shtator në Lubljanë, Slloveni konferencën e 5-të vjetore mbi konceptet themelore në sigurime "Back to Basis".

Në pjesën e parë të konferencës, u vu theksi në sfidat e hershme me të cilat është përballur tregu i sigurimeve e që janë nënvleftësuar vitet e fundit, në një periudhë kur ky treg është orientuar drejt dixhitalizimit.

Në pjesën e dytë të konferencës u diskutua mbi parimet themelore të praktikave të marrjes në sigurim, ekuilibrin midis cilësisë dhe konkurrencës dhe limitet e dixhitalizimit në sektorin e sigurimeve, tendencat e praktikave të ngurta të nënshkrimit të kontratave, etj. Pjesë e diskutimeve ishin dhe trendet më të fundit në fushën e transportit si industria me influencë të konsiderueshme në tregun e sigurimeve të Sllovenisë dhe vendet fqinje në rajon.

Në këtë konferencë morën pjesë hartues të politikave dhe drejtues të industrisë së sigurimeve. Përfaqësuesit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare shprehën rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për çështjet në tregun e sigurimeve.


Informacion më të detajuar për Konferencën e 5-të Vjetore "Back to Basics" B2B gjendet në site në Internet:

<https://www.a-zn.si/en/agency/events/back-to-basics/>


Klasifikimi i tregjeve financiare sipas pretendimeve (Financial Claims¹)

Pretendimi financiar është e drejta për të marrë një pagesë të caktuar, mbi një hua, mbështetur në një kontratë të lidhur midis dy subjekteve. Në rastin e kredisë bankare, banka ka pretendim mbi këstet e huasë që do të duhen të shlyen nga klientët huamarrës. E njëjta gjë vlen edhe për tregjet financiare të letrave me vlerë ku pretendimet mund të ndryshojnë në formë nga kredia bankare por jo në kuptimin e tyre. Në rastin e bonos së thesarit, qeveria shet bono me çmim 900 lek dhe i blen pas një viti me çmim 1000 lek. Diferenca konsiderohet si e ardhur nga interesi i bonos. Në rastin e një obligacioni 10 vjeçar, blerësi i obligacionit ka pretendim mbi pagesat mujore (pagesat e kuponit) që do të bëjë shitësi i obligacionit si edhe mbi pagesën finale (vlerën nominale) që duhet të shlyejë në fund të periudhës 10 vjeçare.

Pretendimet në shuma fikse



Pretendime pronësie




Fjalori i termave statistikore të OECD <https://stats.oecd.org/glossary/detail.asp?ID=963>, Financial claims and obligations arise out of contractual relationships between pairs of institutional units. A financial claim:

(a) entitles a creditor to receive a payment, or payments, from a debtor in circumstances specified in a contract between them; or (b) specifies between the two parties' certain rights or obligations, the nature of which requires them to be treated as financial.

Klasifikimi i tregjeve financiare sipas afatit të maturimit të pretendimit

Maturimi lidhet me përfundimin e kontratës mes huadhënësit dhe huamarrësit ku ky i fundit duhet të ketë shlyer të gjithë pjesën e mbetur të huasë së marrë. Duhet theksuar se afati maturimit si koncept vlen vetëm për letrat me vlerë të borxhit si bonot e thesarit dhe obligacionet dhe nuk vlen për aksionet të cilat teorikisht nuk kanë afat maturimi por ekzistojnë përsa kohë firma operon rregullisht në një treg. Ashtu si një kredi bankare ka një afat kohor për t'u shlyer, edhe letrat me vlerë si bonot dhe obligacionet kanë afatet e tyre kohore.



Funksioni i instrumentit financiar ²

- Transferimi i fondeve nga ato subjekte që i kanë me tepri dhe duan t'i investojnë tek ato subjekte që kanë nevojë për fonde.

Tri funksionet ekonomike që sigurohen nga tregjet financiare

- Ofrojnë mekanizmin e përcaktimit të çmimit të instrumentit financiar
- I bëjnë instrumentet financiarë më likuide
- Zvogëlojnë kostot e shkëmbimit të instrumenteve

Dy llojet e mënyrave të financimit të një firme

- Duke marrë borxh (kredi në bankë ose shitje obligacioni në tregun financiar)
- Duke emetuar aksione pronësie

²Fabozzi, J.F , Modigliani, F (2013) : “Tregjet e kapitaleve : Institucionet dhe instrumentat” Shtëpia Botuese Media Print, Tiranë

Dallimet ndërmjet obligacioneve dhe aksioneve

Blerësi i obligacionit bëhet kreditor i firmës dhe pret prej saj pagesa të rregullta interesi ashtu sikurse banka pret këstet e kredisë nga klientët.

Blerësi i aksionit bëhet pronar i firmës për atë % të aksioneve që blen. Ai nuk pret pagesa interesash të rregullta por dividenta që paguhen në varësi të fitimeve që realizon firma.

Firma fillimisht paguan zotëruesit e obligacioneve dhe me pjesën e mbetur të parave paguan aksionarët. Kështu zotëruesit e obligacioneve janë më të sigurtë në rast falimentimi të firmës. Nga ana tjetër zotëruesit e aksioneve mund të marrin pagesa më të larta nëse firma është e suksesshme në treg.

Obligacioni ka afat maturimi të përcaktuar që varion nga 10 deri në 30 vjet. Aksioni nuk ka afat maturimi dhe paguan dividend përsa kohë firma qëndron në treg.

Mbajtësit e obligacioneve ashtu si edhe aksionarët mund të kërkojnë t'i shesin letrat e tyre me vlerë në këmbim të parave kesh. Për këtë ato iu drejtohen tregut financiar i cili bashkon blerësit dhe shitësit dhe mundëson kthimin e letrave me vlerë në para kesh.

Llojet e aksioneve

Aksionet e zakonshme	Aksionet e preferuara
<p>Përfaqësojnë tituj pronësie në një kompani.</p> <p>Çdo aksion i zakonshëm i siguron pronarit një votë për çdo çështje të drejtimit të kompanisë që votohet në mbledhjen vjetore të saj si edhe një pjesë në përfitimet financiare të pronësisë.</p> <p>Dy karakteristikat e investimit në aksione janë:</p> <p>(i) E drejta mbi atë që mbetet: Do të thotë që aksionarët janë të fundit në radhën e atyre që pretendojnë një pjesë nga përfitimet e kompanisë. Në rast falimentimi të kompanisë aksionarëve u paguhet pjesa e mbetur pasi janë shlyer taksat, pagat e punonjësve, furnitorët, zotëruesit e obligacioneve dhe kreditorët e tjerë. Për një kompani me ecuri normale aksionarët kanë të drejtë për pjesën që ngel pasi janë paguar taksat dhe interesat e borxheve.</p> <p>(ii) Përgjegjësia e kufizuar: Nënkupton se aksionarët në rast falimentimi do të humbasin vetëm vlerën fillestare të investimit të tyre duke mos patur asnjë detyrim personal për borxhet e kompanisë</p>	<p>Premtojnë të paguajnë një sasi parash fikse për çdo vit.</p> <p>Pra aksioni i preferuar është i ngjashëm me një obligacion me maturim të pakufizuar.</p> <p>Ai gjithashtu nuk gëzon të drejtë vote si aksioni i zakonshëm.</p> <p>Aksionarët e preferuar paguhen para aksionarëve të zakonshëm por gjithmonë pasi janë shlyer interesat e obligacioneve.</p> <p>Aksioni i preferuar mund të jetë i këmbyeshem në aksione të zakonshme me një raport këmbimi të specifikuar.</p>

Fjalori i Termave³

Bono Thesari – Letra me vlerë mjaft likuide që përfaqësojnë borxhin afatshkurtër të një qeverie (muajore, 3 muaj, 6 muaj dhe 1 vit).

Debitori – Personi që merr para (fonde) borxh kundrejt një kontrate që përcakton detyrimet , ndryshe quhet huamarrësi.

Fond Investimi – Firmë financiare që bashkon fondet e investuesve dhe i menaxhon ato.

Inflacioni – Norma me të cilën rritet niveli i përgjithshëm i çmimeve të mallrave dhe shërbimeve.

Investim – Angazhimi i parave (fondeve të disponueshme) aktuale mbi bazën e pritjes së përfitimit të më shumë parave në të ardhmen.

Inxhinieri Financiare – Krijimi i letrave me vlerë me tipare të veçanta.

Kreditori – Personi që jep një kredi kundrejt një kontrate me kushte të paracaktuara për pretendimet e tij , ndryshe quhet huadhënësi (zakonisht bankat dhe institucionet financiare të ngjashme me to).

Likuiditet – Shpejtësia dhe lehtësia me të cilën një instrument financiar kthehet në para kesh.

Tregu i parasë – Tregu ku shiten dhe blihen instrumenta financiare afatshkurtra, mjaft likuide dhe me rrezik të ulët (psh. Bonot e thesarit).

Tregu i kapitalit – Tregjet ku shiten dhe blihen letra me vlerë më afatgjata dhe që janë relativisht me më shumë rrezik (psh. Obligacionet & aksionet).

Tregu primar – Tregu nëpërmjet të cilit i ofrohen për herë të parë letrat me vlerë të sapo emetuara publikut.

Tregu sekondar – Tregu ku shiten dhe blihen letrat me vlerë ekzistuese (ato letra që janë emtuar më parë në tregun primar e që mund të ndërrojnë pronësinë në tregun sekondar siç është Bursa).

³Bodie, Z , Kane, A , Marcus, J.A (2014): “Investimet 1” Shtëpia Botuese Media Print, Tiranë


JOURNAL OF PENSION ECONOMICS & FINANCE

Volumi 18, tetor 2019 përmban këto shkrime kryesore:

- Reforma e pensioneve dhe politikat e kthimit në punë
(Pension reform and return-to-work policies)

- Dalja në pension e punonjësve të sektorit publik shtetëror dhe vendor: Roli i stimujve financiarë
(Retirement choices by state and local public sector employees: the role of eligibility and financial incentives)

- Tranzicionet e karrierës, ndryshimet e punësimit në sektorin privat dhe publik
(Transitions from career employment among public- and private-sector workers)



Hungari

www.xprimm.com

Moti i keq që përfshiu Hungarinë në periudhën nga maji deri në fund të gushtit ka bërë që siguruesit të paguajnë 4.1 miliardë forinta (HUF, monedha lokale) ose rreth 12 milionë euro për sigurimin e pronës. Përgjatë muajve të verës, siguruesit morën rreth 100 mijë njoftime në lidhje me dëmtimet e ndryshme në pronë, nga përmbytjet, tre herë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Kosovë

www.xprimm.com

Shoqëritë e sigurimit në Kosovë janë lehtësuar nga taksa prej 5% të primeve të shkruara bruto që duhet të paguanin. Kjo në bazë të një vendimi të Kuvendit në muajin korrik, pasi në muajin prill Gjykata Kushtetuese kishte vlerësuar si antikushtetuese edhe taksën tjetër prej 1% që shkonte për Kryqin e Kuq.

Duke qënë se taksa prej 5% nuk lidhej me fitimet e siguruesit, por me primet e shkruara bruto, ajo kishte krijuar shumë probleme financiare për shoqëritë. Sipas vlerësimeve të Shoqatë së Siguruesve të Kosovës rreth 60 milionë euro janë shpenzuar nga shoqëritë për pagesën e kësaj takse përgjatë këtyre viteve.

Ndërkohë primet e shkruara bruto për 6-mujorin e parë të vitit 2019 në tregun e sigurimeve në Kosovë arritën në 48.4 milionë euro, me një rritje prej 7.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimi i Jetës u rrit me 20%, duke arritur në 1.8 milionë euro. Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 7.3%, duke arritur në 46.6 milionë euro. Dëmet e paguara bruto ishin 24.9 milionë euro, me një rritje prej 11.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Kroaci

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto për 6-mujorin e parë të vitit 2019 në tregun e sigurimeve në Kroaci arritën në 784 milionë euro, me një rritje prej 7.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, më së shumti për shkak të rritjes së sigurimit të Jo-Jetës. Në veçanti sigurimi motorik pësoi rritjen më të madhe, me 18.7%. Ndërsa sigurimi i Jetës ka qendruar thujtë në të njëjtat nivele krahasuar me një vit më parë.

Mali i Zi

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Malin e Zi për 6-mujorin e parë të vitit 2019 arritën në 46.6 milionë euro, me një rritje prej 14% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Si në sigurimin e Jetës, ashtu edhe në atë të Jo-Jetës ka patur rritje dyshifrore. Struktura e tregut mbeti thujtë e pandryshuar, me një rënie të lehtë të sigurimit motorik përkundrejt sigurimit të pronës.

Maqedonia e Veriut

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto për 6-mujorin e parë të vitit 2019 në tregun e sigurimeve në Maqedoninë e Veriut arritën në 85.37 milionë euro, me një rritje prej 6.7%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimi i Jetës pësoi rritje të ndjeshme, me 14%, por përsëri portofoli i tij mbetet modest, me 13.8 milionë euro prime të shkruara bruto. Në sigurimin e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto arritën në 41.37 milionë euro, me një rritje prej 5%.

Poloni

www.xprimm.com

Sipas vlerësimeve të Fondit të Garancisë së Sigurimeve në Poloni, 80,000-90,000 mjete qarkullojnë pa një policë sigurimi TPL, që përbën 0.4-0.5% të numrit të përgjithshëm të mjeteve. Kjo shifër e bën Poloninë një nga vendet më të mbuluara nga ky lloj sigurimi në Evropën Qendrore e Lindore, së bashku me Slloveninë dhe Republikën Çeke.

Gjobat e larta për mungesë siguracioni (deri në 1 mijë euro për automjetet), si edhe parashikimet ligjore që përcaktojnë se dëmet e aksidenteve të shkaktuara nga mjetet e pasiguruara duhet të paguhet nga pronarët e tyre janë disa nga masat që kanë ndikuar në uljen e mjeteve të pasiguruara në Poloni.

Rumani

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto për 6-mujorin e parë të vitit 2019 në tregun e sigurimeve në Rumani arritën në 1.14 miliardë euro, me një rritje prej 6.13% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dëmet e paguara për këtë periudhë janë 708 milionë euro, me një rritje prej 17.55%. Sigurimi i Jetës ka ruajtur pozicionin e tij të zakonshëm në treg, me 21% të totalit, ose me 237.5 milionë euro prime të shkruara bruto. Rreth 75% të sigurimit të Jo-Jetës e zë sigurimi motorik, me 565.5 milionë euro prime të shkruara bruto për 6-mujorin e parë.

Serbi

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Serbi arritën në 455.6 milionë euro për 6 muajt e parë të vitit 2019, me një rritje prej 3.08% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së primeve në sigurimin e Jo-Jetës, më së shumti në sigurimin motorik.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e pronës pësuan rënie me 3.4%. Ndërkohë, në të njëjtën kategori sigurimi u pagua edhe sasia më e madhe e dëmeve, kryesisht për shkak të përmbytjeve që goditën vendin në periudhën maj-qershor.

Sigurimi motorik ruajti pozitën dominuese në treg, me 41.3% të totalit sa i përket primeve të shkruara bruto.

Turqi

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Turqi arritën në 33.23 miliardë lira (TRY, monedha lokale) për gjashtë muajt e parë të vitit 2019, me një rritje prej 19.23%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Megjithatë, nëse merret në konsideratë norma e lartë e inflacionit (15.72% në fund të qershorit), rritja e tregut në terma realë ishte thuhetse zero. Sigurimi i Jetës zë 13.8% të totalit të tregut, ndërsa pjesa më e madhe e sigurimeve të Jo-Jetës nuk e kanë ndryshuar peshën e tyre në treg.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al